

VENDIM
Nr. 433, datë 3.6.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT “STUDIM PROJEKTIM BY-PASS TEPELENË, LOTI 1”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Studim projektim By-Pass Tepelenë, loti 1”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 23 946 990.99 (njëzet e tre milionë e nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, për pasuritë e llojit “trual” dhe “ndërtesë jo banimi”.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 23 946 990.99 (njëzet e tre milionë e nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2020, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tepelenë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tepelenë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e pronareve te pasurive prone private qe shpnotesohen nga ndertimi i projektit "Studim Projektim By Pass Tepelenë, loti 1 "

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas zvrpp)									VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. Totale (m2)	Shpronësim tokë "truall"			Ndërtesë jo banimi			
								Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip.Nd. konf.nga ZVRPP (m2)	Vlera sipas Preventivit (lekë)		
1	Edar	Hasan	Qëndrai	3574	10/6	truall+ndërtësë	104	104	1015	105,560	74	1,645,255.57	1,750,815.6	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
2	Edar	Hasan	Qëndrai	3574	10/206	truall+ndërtësë	82	64	1015	64,960	98.6	2,531,459.68	2,596,419.7	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
3	Klodian	Gezim	Çunaj	3574	10/7	truall+ndërtësë	100	50	1015	50,750	100	3,741,807.49	3,792,557.5	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
4	Gezim		Çunaj	3574	10/11	truall+ndërtësë	810	638	1015	647,570	208	6,262,439.42	6,910,009.4	Konf. ZVRPP. Kufizim veprimesh mbi pasurinë për parregullsi.
	Mimoza		Duma											
	Klodian		Çunaj											
	Ilirjan		Çunaj											
	Kristian		Lalo											
	Eni		Çunaj											
	Merita		Lalo											
Ema		Lalo												
5	Ali	Zaim	Abazi	3574	10/113	truall+ndërtësë	84	1	1015	1,015	168	5,407,684.36	5,408,699.4	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
6	Habil	Muhamet	Goxha	3574	8/68	truall+ndërtësë	78	67	1015	68,005	52	1,172,021.90	1,240,026.9	Konf. ZVRPP. Kufizim veprimesh mbi pasurinë për parregullsi.
7	Agim		Baca	3574	10/5	truall+ndërtësë	64	60	1015	60,900	64	1,998,772.57	2,059,672.6	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
8	Elidon	Levend	Malaj	3574	10/208	truall	237	141	1015	143,115			143,115	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
9	Hektor	Barjam	Agaraj	3574	10/2	truall	48	45	1015	45,675			45,675	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
S H U M A								1170		1,187,550	764.60	22,759,440.99	23,946,990.99	